



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RETHIT ELBASAN
NR.788 R.TH.A-PENAL DT. 1.7.2014
NR.788 I VENDIMIT DATE 1.7.2014

V E N D I M
" PER SHQYRTIMIN E KERKESES PER VENDOSJE MASE SIGURIMI
PASUROR "

Gjykata e rrethit Elbasan e perbere prej :
GJYQTARIT ILIR PASHAJ,

Asistuar prej sekretares Jorna Santo , ne Elbasan, me daten 1.7.2014 shqyrtoi ne séance gjyqesore ceshtjen penale qe i perket kerkeses se paraitur prej :

PROKURORISE SE RRETHIT ELBASAN , e perfaqesuar prej prokurorit
Kreshnik Ajazi,

ME OBJEKT : Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros
preventive te llogarive bankare.

BAZA LIGJORE : Nenet 274 i K.P.Penale.

Ne perfundim te gjykimit, pas degjimit te relacionit te prokurorit, administrimit te provave te nevojshme , si u degjua prokurori Kreshnik Ajazi qe kerkoi pranimin e kerkeses,Gjykata si shqyrtoi provat dhe ceshtjen ne teresi .

V E R E N :

Prokuroria e rrethit Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr.1547 te vitit 2014 per vepren penale "pastrimi i produkteve te vepores penale dhe veprimtarise kriminale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal, ne ngarkim te shtetasit Adhurim Selmani, biri i Gafur dhe Qanije, dtl.1973,lindur ne Maqellare , Diber dhe banues ne Lagje "Beqir Dardha",rruga "Refik Serica", pallati 77, i martuar, me kombesi e shtetesi shqiptare.

Sa relatohet nga kerkesa e prokurorit, Adhurim Selmani ne daten 18.6.2014 ka marre ne llogarine e tij bankare ne Banken Kombetare Tregetare (te celur prej tij ne maj 2014) nje shume te hollash prej 25000 paund britanike me transferues te hollash shtetasin e huaj Omar Mohammed Khan, i perfshire ne veprimtari terroriste ne shtetin anglez, transaksion pa specifikime per aresyet e dergeses, pra transaksion i dyshuar prej burimeve te dyshimta.

Ne keto kushte prokurori aresyeton se eshte e nevojshme te vendoset masa e sigurimit pasuror e sekustros preventive mbi llogarite bankare te Adhurim Selmani p[riane B.K.Tregetare , pasi sipas prokurorit lenia e lire e transaksioneve mbi keto llogari

VENDOSI:

1. Pranimin e kerkeses. Vendosjone mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarine bankare nr. 405779076 prane B"Bankes Kombetare Tregetare " sh.a (dega Elbasan) ne emer te personit ne hetim Adhurim Gafur Selmani, dt.30.3.1973.

2. Nje kopje e kletij vendimi ti dergohet "Bankes Kombetare Tregetare " sh.a

3. Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen sherbimet e policise gjyqesore prane Drejtorise se Paolicise se Qarkut Elbasan.

Kunder vendimit lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Durres brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes .Per personat e interesuar ky afat nis nga e nesermja e marrjes dijeni.

U shpall ne Elbasan me datën 1.7.2014.

SEKRETARE

Jorna Santo

GJYQTARI

ILIR PASHAJ

Sipas ankimit te paraqitur nga Adhurim Selmani.

Vendimi ka marre forme te prere me dt.04.08.2014

Pasi me vendimin nr.10-2014-2503/285 date 04.08.2014 te Gjykates se Apelit Durres eshte vendosur :

Miratimin e vendimit nr.788 date 01.07.2014 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

Avokati kryesisht, Vasil Dode te parapaguhet sipas tarifave zyrtare.

Kunder ketij vendimi mund te behet recurs, Brenda 30 diteve, ne Gjykatën e Larte.

- Me shkresen nr. 788 date 19.09.2014 vendimi ju dergua organit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

K/SEKRETARI

Lindita CELA

KANCELARE

Merita DURO

Sipas rekursit te bere nga I gjykuari Adhurim Selmani.

Me vendimin Nr. 00-2014-1601, date 06.11.2014 te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte eshte vendosur:

Mospranimin e rekursit te paraqitur nga I gjykuari Adhurim Selmani perfaqsuar nga av. Vasil Dode, ndaj vendimit Nr. 10-2014-2503 (285), date 04.08.2014 te Gjykates se Apelit Durres.

K/SEKRETARE

Lindita CELA

KANCELARI

Ledio SULKUQI

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrës
nr. 00-2014-1601, datë 06.11.2014
aktivi L. 23/11/2014